



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
BASHKIA GRAMSH  
KËSHILLI BASHKIAK

PROÇESVERBAL

Mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Muaji MAJ mbajtur sot me datë 31/05/2024 ora 10:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak.

Në mbledhje marrin pjesë 14 këshilltarë: Luljeta Dollani, Enis Zani, Albert Ceci, Brunilda Gjevori, Arnilda Dakare, Dalip Hazizaj, Brunilda Ballolli, Fatbardh Cekrezi, Visarion Bici, Edmond Guri, Erald Carciu, Idri Kokla, Erisa Zogu, Marsela Ibro.

Mbledhja drejtohet nga Kryetari i Këshillit z. Enis Zani.

Në zbatim të Nenit 192 të rregullores së Këshillit Bashkiak; "Kryetari i Bashkisë ka të drejtë të ftojë stafin e tij në mbledhjet e Këshillit, për të dhënë shpjegime juridike dhe ligjore për projekt vendimet e paraqitura nga ekzekutivi në mbledhjen e Këshillit"; asistuan në mbledhje disa prej drejtorëve dhe përgjegjesit e drejtorive përkatëse që dorëzuan projekt vendimet dhe relacionet, merr pjesë Zv/Kryetari i Bashkisë, T. Bici.

**E.Zani:** Pershendetje, kurumi është plotësuar, mbledhjen e deklaroj të hapur. Kemi përveç pikave në rend dite edhe një material për ta futur dhe diskutuar rishtazi lidhur me "Domosdoshmerine e vendosjes së tarifave të shërbimit të kanalizimeve të ujërave të ndotura njesine Ujesjeslles Kanalizime Gramsh", jeni dakort të futet në rend dite?

**E.Guri:** Para se të votojmë për ta futur në rend dite duhet të rikujtoj që ligji me të cilin në veprimet prevalon mbi VKM.

**E.Carciu:** Diskuton mbi transmetimin e mbledhjeve online dhe mbi domosdoshmerine për ta respektuar këtë procedurë.

Largohet nga mbledhja E.Carciu.

**\*Ne mbledhje marrin pjesë 13 këshilltarë.**

**A.Ceci:** Kjo pikë (materiali që propozohet të futet në rend dite) a ka nevojë për degjese publike?

**E.Zani:** Duke qenë se edhe përfaqësuesi i Elbasanit nuk ka ardhur jam i mendimit që kjo pikë të shtyhet për diskutim në një moment tjetër.

**A.Ceci:** Për mua degjese publike është një hallkë që nuk duhet kapercyer pasi të çeshtja e cmimit ndjeshmeria është e madhe.

**E.Zani:** Votojmë rendin e ditës, pa futur këtë pikë që diskutuam?

**\*Miratohet rendi i ditës me 13 Vota PRO**

Sekretar i Këshillit  
Xhulia Gjini



Kryetar i Këshillit  
Enis Zani

## Çështja 1

### 1- Për dhënien e ndihmës ekonomike për muajin Prill 2024 (fondi 6%).

Në mbledhje marrin pjesë 13 këshilltarë: Luljeta Dollani, Enis Zani, Albert Ceci, Brunilda Gjevori, Arnilda Dakare, Dalip Hazizaj, Brunilda Ballolli, Fatbardh Cekrezi, Visarion Bici, Edmond Guri, Idri Kokla, Erisa Zogu, Marsela Ibro.

**Pergj.Ndh.Ek:** Pershendetje, per muajin Prill jane gjeneruar 31 familje nga sistemi elektronik per te perfituar, ftoj te miratohet.

**F.Cekrezi:** Kane qene me shume familje heret e tjera.

**Pergj.Ndh.Ek:** Pas nje viti aplikim kane te drejte riaplikimi.



**E.Zani:** Votojme?

**\*Miratohet pika e 1 e rendit të ditës me 13 Vota PRO**

Sekretar i Këshillit  
Xhulia Gjini

Kryetar i Këshillit  
Enis Zani

Adresa: Sheshi "Kamber Dermysli" Bulevardi "10 Korriku" Tel.Fax:0513 2 2272 E-mail:bashkiagramsh@gmail.com


Çështja 2 & 3

- 2- Për dhënien e ndihmës financiare z.Adriatik Bitra.
- 3- Për dhënien e ndihmës financiare znj.Thëllënxë Llalla.

Në mbledhje marrin pjesë 13 këshilltarë: Luljeta Dollani, Enis Zani, Albert Ceci, Brunilda Gjevori, Arnilda Dakare, Dalip Hazizaj, Brunilda Ballolli, Fatbardh Cekrezi, Visarion Bici, Edmond Guri, Idri Kokla, Erisa Zogu, Marsela Ibro.

**E.Zani:** Kemi dy raste për dhenie të ndihmës financiare, **z.A.Bitra** në gjendje shumë të rëndë dhe me tre femije invalid dhe **znj.Th.Llalla** e cila vuan nga një sëmundje tumorale dhe është në fazë trajtimi mjekësor.

Votojme për të dy rastet?

**\*Miratohet pika e 2 e rendit të ditës me 13 Vota PRO**

**\*Miratohet pika e 3 e rendit të ditës me 13 Vota PRO**

Sekretar i Këshillit  
Xhulia Gjini

Kryetar i Këshillit  
Enis Zani

Adresa: Sheshi "Kamfer Dermyshe" Bulevardi "10 Korriku" Tel.Fax:0513 23272 E-mail:bashkiagranesh@gmail.com

Visarion Bici



Albert Ceci

## Çështja 4 & 5

- 4- Për miratimin e Tavanëve të Buxhetit Afat-Mesëm 2025-2027
- 5- Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027

Në mbledhje marrin pjesë 13 këshilltarë: Luljeta Dollani, Enis Zani, Albert Ceci, Brunilda Gjevori, Arnilda Dakare, Dalip Hazizaj, Brunilda Ballolli, Fatbardh Cekrezi, Visarion Bici, Edmond Guri, Idri Kokla, Erisa Zogu, Marsela Ibro.

**Dr. Ekonomik:** Kemi një draft projekt, në qershor PBA dërgohet në Ministri të cilet bëjnë observacionet e tyre, me pas vazhdojmë me degjësia publike.

Në fq.14 kemi të dhëna të specifikuar, në fq.16 kemi të dhëna ku jemi orientuar me shumë, në fq.20 kemi tabelat për shpenzimet (ben edhe disa parashikime në vijë të përgjithshme).

Vijohet me shpjegimin e disa projekteve disa prej të cilave me dy vite financim.

**F. Cekrezi:** Prania e Kryetarit të Bashkisë për zhvillime strategjike është e domosdoshme; ligji 78/2017 nën 51 pikë 1 përcakton si afat 15 Marsin jo 31 Maj. Ajo që me ben me shumë pershtypje është që rrjeti rrugor rural vjen në rënje. Parashikimi duhet të jetë progresiv.

**Dr. Ekonomik:** Shpenzimet korrente janë në rritje, e vertetë që detyrim është 15 Marsi, por risia është që në punojmë online, kemi ecur paralelisht me gjithë bashkitë, jemi në trajnim të vazhdueshëm.

**E. Zani:** Ka pyetje?

**E. Guri:** Do doja të bëja pyetje Komisionit në fakt i cili nuk u mbledh, dhe janë duke e shkelur rregulloren në këte mënyrë. Mos duhet të rishikojmë edhe njëherë komisionet?

**F. Cekrezi:** Komisioni i cili vazhdimisht nuk mbledhet quhet i vetshpërndarë, duhen ndryshuar anëtarët e Komisionit.

**E. Zani:** Do e shohim riformatimin e komisioneve.

Votojmë materialet 4 dhe 5 ?


**\*Miratohet pika e 4 e rendit të ditës me 13 Vota PRO**

**\*Miratohet pika e 5 e rendit të ditës me 13 Vota PRO**

Sekretar i Këshillit  
Xhulia Gjini

Kryetar i Këshillit  
Enis Zani

Adresa: Sheshi "Kamber Dermishi" Bulevardi "10 Korriku" Tel.Fax:0513 2 2272 E-mail:bashkia@gramsh@gmail.com



## Çështja 6

### 6- Për ndryshimin e orarit të linjës Gribë-Gramsh dhe Kukur - Gramsh.

Në mbledhje marrin pjesë 13 këshilltarë: Luljeta Dollani, Enis Zani, Albert Ceci, Brunilda Gjevori, Arnilda Dakare, Dalip Hazizaj, Brunilda Ballolli, Fatbardh Cekrezi, Visarion Bici, Edmond Guri, Idri Kokla, Erisa Zogu, Marsela Ibro.

**Dr. Taksave:** Nis të relatoje materialin duke cituar oraret e linjave perkatese. Subjektet jane te rregullta qe paguajne taksat dhe kerkesa vjen nga komuniteti.

**V. Bici:** Ka perplasje me oraret , per Kukurin?

**Dr. Taksave:** Jo nuk ka.

**E. Zani:** Pyetje?

**F. Cekrezi:** Relacioni duhet te jete me i plote .

**E. Zani:** Votojme?

**\*Miratohet pika e 6 e rendit të ditës me 13 Vota PRO**

Sekretar i Këshillit  
Xhulia Gjini



Adresa: Sheshi "Kamber Dermynshi" Bulevardi "10 Korriku" Tel. Fax: 0513 2 2272 E-mail: bashkiagramsh@gmail.com

## Çështja 7

### 7-Miratimi i planit lokal të menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane 2024-2029,për Bashkinë Gramsh

Në mbledhje marrin pjesë 13 këshilltarë: Luljeta Dollani, Enis Zani, Albert Ceci, Brunilda Gjevori, Arnilda Dakare, Dalip Hazizaj, Brunilda Ballolli, Fatbardh Cekrezi, Visarion Bici, Edmond Guri, Idri Kokla, Erisa Zogu, Marsela Ibro.

**Perf.i Bashkive te Forta:** Plani ka nisur nga shtatori i vitit te kaluar, nje plan ku pronesia eshte e bashkise Gramsh, drafti eshte i publikuar ne faqen zyrtare te bashkise. Kemi bere degjesat e duhura ku ka marre pjese edhe komisioni i Sherbimeve Publike.

**F.Cekrezi:** Cfare impakti ka?

**E.Kaso(Nenkryetarja):** Jemi per nje plan te ri, konsultimi publik eshte bere dhe ju keni qene prezent. Sygjerimet tuaja jane marre parasysh. Ky sherbim do te ofrohet, do te ishte me vend qe te vini me sygjerime konkrete nese ju keni rezerva per planin.

Plani eshte 5-vjecar, i cili ka te detajuar se cfare sherbimesh do te kryeje. Jane 3 skenare ne total. Zona urbane mbulohet 100% me sherbimin e pastrimit, zona rurale do te shkoje ne 70%(afat 5 vjecar). Sa i perket planit cakton 3 drejtime: 1- zona e mbulimit, 2- menyra si do operohet me mbledhjen e mbetjeve, 3-performanca, niveli i mbulimit te kostos nga taksat dhe tarifat. Kostimi eshte bere ne baze te VKM. Pjesa e mbetjeve biologjike do shkoje per kompostim, pretendojme te bejme ndarje dhe perpunim te mbetjeve.

**E.Guri:** Vleresoj punen por kam nje pyetje. Sa degjesa jane bere? Ajo qe na prek jane tarifat.

**E.Kaso:** Ne lidhje me degjesat jane bere 3 ne total, lidhur me pyetjen, plani permban seksionin "ankesa" te cilen qytetaret kane te drejte ta perdorin per problematika te ndryshme dhe ta protokollojne, dhe drejtoria perkatese ka detyrim tu pergjigjet.

Per pjesen e tarifave( 210 leke ne vit ne qytet, 90 leke ne zonat rurale, sherbimi eshte i kushtueshem por i perballueshem sipas opinionit tone, ju keni te drejte te propozoni ndryshime kur te kaloni tarifat, plani nuk ka te beje me ndryshim tarifash .

**V.Bici:** A ka selektivitet te zonave turistike?

**E.Kaso:** Qe te vizioni eshte percaktuar qe zonat turistike do te kene prioritet, eshte bere edhe si sygjerim ne degjesat publike.

**E.Zani:** Votojme?


**E.Zani:** Jeni te qarte, votojme?

\*Miratohet pika e 7 e rendit të ditës me 13 Vota PRO

Sekretar i Këshillit  
Xhulia Gjini

Kryetar i Këshillit  
Enis Zani

Adresa: Sheshi "Kamber Dermyshe" Bulevardi "10 Korriku" Tel.Fax:0513 2 2272 E-mail:bashkiagramsh@gmail.com



## Çështja 8

### 8- Të tjera, Kërkesa nga Qytetarët.

Në mbledhje marrin pjesë 13 këshilltarë: Luljeta Dollani, Enis Zani, Albert Ceci, Brunilda Gjevori, Arnilda Dakare, Dalip Hazizaj, Brunilda Ballolli, Fatbardh Cekrezi, Visarion Bici, Edmond Guri, Idri Kokla, Erisa Zogu, Marsela Ibro.

#### Relaton kryetari i Komisionit Keshillimor

**A.Ceci:** Komisioni Keshillimor zhvilloi mbledhjen për të diskutuar mbi propozimet e sjella (Nis të lexojë raportin e komisionit dhe propozimet).

Nis me propozimet e bera nga Organizata e Familjeve të Deshmorëve, propozime për dhënien e titullit “Deshmor i Atdheut”. Relaton të 4 personat e propozuar (referohu raportit) dhe lexon historikun e tyre.

**E.Zani:** Kalojmë në votim për propozimet e bera për dhënien e titullit “Deshmor i Atdheut”?

**\*Miratohet dhënia e titullit “Deshmor i Atdheut” për të propozuarit: z.Partizan Ferit Kasmi, z.Zenun Halil Berhami; z.Selman Xhemal Hasa, z.Nijas Bektash Demollari; me 13 vota PRO.**

**A.Ceci:** Propozimet e tjera vijnë nga Pergjegjësi i Pallatit të Kulturës. Dy rastet e propozuara: Për dhënien e titullit Orkestrinës Popullore me instrumentet karakteristike të rrethit të Gramshit, “Orkestrina Alajdin Topçiu” dhe dhënies së titullit vendor të nderit “Qytetar Nderi” regjizorit z.Shaban Hysen Klllogjeri.

**E.Zani:** Une them të krijohet njëherë orkestrina pasi problemi qëndron që nuk e kemi fizikisht.

**E.Guri:** Sygjerohet krijimin e një bande, të bëhet një investim nga bashkia për ngritjen dhe krijimin e saj.

**E.Zani:** Propozojmë të shtyjmë dhënien e titullit Orkestrinës Popullore me instrumentet karakteristike të rrethit të Gramshit, “Orkestrina Alajdin Topçiu” deri në momentin e krijimit të kesaj orkestrine njëherë?

**\*Miratohet shtyrja e këtij propozimi me 10 vota PRO.**

**\*Votuan 3 Kunder shtyrjes së këtij propozimi: V.Bici, L.Dollani, A.Ceci.**

**A.Ceci:** Propozimi për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” ish-mësuesit specialist z.Rrapush Zili (propozuar nga Shoqata Mbarëkombëtare Normaliste) si dhe për të njëjtin titull regjizorit z.Shaban Hysen Klllogjeri.

**E.Zani:** Dergojmë njëherë këto propozime të Autoritetit të Dosjeve dhe të diskutojmë seriozisht një moment të dytë?

**\*Miratohet shtyrja e këtij propozimi me 13 vota PRO.**

Adresa: Sheshi “Kamber Dermishi” Bulevardi “10 Korriku” Tel.Fax:0513 2 2272 E-mail:bashkiagramsh@gmail.com

Visarion Bici

Albert Ceci

Diskutohet edhe propozimi per ndryshimin e emertimit te "Shkolles 35-Vjetori i Clirimit" ,per te cilin Komisioni shprehet se dokumentacioni nuk eshte i plote, dhe mbi te gjitha citon qe te mos nxitohet ne marrjen e vendimeve te cilat mund te cenojne vendime te meparshme pasi konstatohet se titulli i propozuar per shkollen, emertimi "Hamit Dollani" i eshte vendosur nje Rruge. Ndodhur ne kushte te tilla edhe per kete propozim Komisioni shprehet per shtyrjen e tij ne nje moment tjetër .

**E.Zani:** Votojme shtyrjen e ketij propozimi?

**\* Miratohet shtyrja e ketij propozimi me 13 vota PRO.**

**Mbledhja deklarohet e mbyllur!**

**Sekretar i Këshillit  
Xhulia Gjini**



**Kryetar i Këshillit  
Emis Zani**

Adresa: Sheshi "Kamber Dermyshe" Bulevardi "10 Korriku" Tel.Fax:0513 2 2272 E-mail:basbkt@gramsh@gmail.com

*Viserion Boci*

*Albert Ccaj*

REPUBLIKA E SHQIPERISË  
BASHKIA GRAMSH  
KESHILLI BASHKIAK

Gramsh, më 31/05/2024



**LISTË PREZENCË E KËSHILLTARËVE BASHKIAK**

Mbledhja e Rradhës e Këshillit Bashkiak Muaji MAJ 2024

EMER MBIEMER	31 MAJ 2024	EMER MBIEMER	FIRMA
1- KODHEL ÇALA			
2- VALBONA VERUSHI			
3- LULJETA DOLLANI	31.05.2024	Luljeta Dollani	[Signature]
4- ENIS ZANI	31.05.2024	Enis Zani	[Signature]
5- GRETA LENA			
6- VISARION BICI	31.05.2024	Visarion Bici	[Signature]
7- ARDIANA HASA			
8- ALBERT CECI		ALBERT CECI	[Signature]
9- RAMAZAN BRAHO			
10- EDMOND GURI	31.05.2024	EDMOND GURI	[Signature]
11- ERALD ÇARÇIU	31.05.2024	Erald Çarçiu	[Signature]
12- IDRI KOKLA	31.05.2024	Idri Kokla	[Signature]
13- ERISA ZOGU	31.05.2024	Erisa Zogu	[Signature]
14- KUJTIM BRAHIMI			
15- MARSELA IBRO	31.05.2024	Marsela Ibro	[Signature]
16- ALFRIDA SHAHINI			
17- DALIP HAZIZAJ	31.05.2024	Dalip Hazizaj	[Signature]
18- ARNILDA DAKARE	31.05.2024	ARNILDA DAKARE	[Signature]
19- BRUNILDA BALLOLLI	31.05.2024	Brunilda Ballolli	[Signature]
20- FATBARDH ÇEKREZI	31.05.2024	Fatbardh Çekrezi	[Signature]
21- BRUNILDA GJEVORI	31.05.2024	Brunilda Gjevori	[Signature]

SEKRETARI I KËSHILLIT  
XHULIA GJINI

Visarion Bici  
[Signature]

[Signature]

Albert Ceci  
[Signature]